



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 49

Datë: 22. 09. 2017, ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.45/2017;

2.Aktivitetet e ZRPP-së;

-Shqyrtim i Rekomandimit për anulim të decertifikimit të kandidatëve të SP-ve, sipas vendimit të Gjykatës Supreme

3.Raport i Këshillave;

Këshilli për Operacione Zgjedhore;

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për zgjedhjet;

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për certifikimin e Listës së Votuesve për zgjedhjet lokale 2017;

-Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve për anëtar të KKZ-ve

-Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit operacional të sigurisë për zgjedhjet lokale 2017;

-Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për procedura të votimit dhe numërimit

-Shqyrtimi dhe miratimi i Fletëvotimeve dhe Broshurave për zgjedhjet lokale 2017

-Shqyrtimi dhe miratimi i sasisë së broshurave dhe Fletëvotimeve për zgjedhjet lokale 2017

-Këshilli për Informim Publik

- Raporti i Këshillit Mbikëqyrës për Informim Publik

-Raport i aktiviteteve të realizuara për IP

4. Të ndryshme

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.45/2017;

Valdete Daka: Pëshëndetje të gjithëve. Besoj që mundemi me fillue kemi kuorum, jemi gjithësejt 8 anëtarë qka siguron kuorumin dhe vendimmarrjen. Atëherë mirë se keni ardhur në mbledhjen e 49 të vitit 2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. E keni rendin ditës para vetit, a ka dikush ndonjë propozim për ndryshim të rendit të ditës apo për plotësim?

Betim Gjoshi: Aktivitetet e Sekretariatit...! Kjo është bërë çdo mbledhje por, çdo mbledhje si po e ngrisim po vije në mbledhjen tjetër aktivitetet e Sekretariatit në një mbledhje po i kemi kur po i kërkojmë, në mbledhjen tjetër prap nuk po na vijnë. Është mirë me ba një praktik rreth kësaj se, jemi në prag të zgjedhjeve, edhe një muaj ditë kanë mbetur zgjedhjet edhe për mua është e rëndësishme që raporti me qenë i aktiviteteve me shkrim. Ndoshta, edhe i kanë sjell raportet e kanë harru mi shti në rend të ditës por, raportet kryeshef po mungon prapë aktiviteti të sekretariatit, me ditë ku është përgatitja e zgjedhjeve.

Adana Rrustemi: Pa dyshim që, është minimumi do të thoja unë i nevojshëm që në çdo mbledhje të kemi një pasqyrim të ecurisë se aktiviteteve por, unë mendoj që për çdo periudhë sidomos ligjore dhe e përcaktuar me plan operacional ne duhet me marr një njoftim përmes e-mail që ka filluar kjo është gjendja se po e zëmë ne e dimë që dje ka filluar fushata parazgjedhore , ndërkohë dje me plan operacional do të duhej të fillonte votimi jashtë vendit. D.m.th. janë gjer aqë ne duhet mu njofto që po zhvillohet po zbatohet plani operacional. Jo veç në

mbledhje e për fat të keq ne nuk i kemi as në mbledhje, unë pajtona që është e domosdoshme përveç që të jep një standard kemi edhe informacione për periudha specifike edhe jashtë mbledhjes.

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare. Ju e keni rekomandimin e zyrës por, e keni edhe për akreditim të vëzhguesve, nëse ka mundësi kjo me hy sot në rend të ditës...

Illir Gashi: Kryetare faleminderit. Po mendoj për pikën Këshilli për Informim publik të shtyhet për mbledhjen e radhës , do të thotë të hiqet sot si pikë e rendit të ditës...

Betim Gjoshi: Kryetare nëse më lejohet, tash po e shoh që edhe pika dy nuk është e plotë përveç asaj që propozoj drejtoresha e zyrës...Ne, e kemi sot edhe me anulua një vendim për certifikim përveç për de certifikim. Në i kemi zëvendësua ata 86 persona i kemi certifikuar, edhe duhet me i de certifikuar tash...

Adnan Rrustemi: Unë pajtohem, janë të ndërlidhura ata dyja ngushtë nuk shkon njëra pa tjetrën d.m.th. nëse e anulojmë vendimin për de certifikim respektivisht duhet ta anulojmë edhe vendimin për certifikim të zëvendësimeve. Nëse eventualisht nuk e kanë listën, ne mundemi me plotësuar pikën e rendit të ditës edhe vendimin mund ta marrim në atë mënyrë që edhe në arsyetim edhe në përcaktim që e anulojmë vendimin për de certifikim dhe rrjedhimisht i kthejmë në listë edhe anulojmë edhe vendimin për certifikim. Ndërkohë, këta i kanë listat për kë bëhet fjalë edhe vazhdon, sipas vendimin shkon se edhe ashtu e kemi një vendim.

Valdete Daka: Në rregull atëherë, kush është për këtë rend dite me këto plotësime.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë atëherë me pikën e parë ato janë procesverbalet. I kemi dy procesverbale, në të vërtet një, e kemi të mbledhjes së 45...Kush është për miratimin e procesverbali ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë procesverbal.

2.Aktivitetet e ZRPP-së

1. Shqyrtim i Rekomandimit per anulim të decertifikimit të kandidatëve të SP-ve, sipas vendimit të Gjykatës Supreme

Valdete Daka: Shkojmë me pikën e dytë të rendit të ditës e ajo është sipas vendimit të gjykatës supreme edhe pse vendimin e gjykatës supreme na zyrtarisht nuk e kemi marr megjithatë d.m.th nuk na është dërguar nga gjykata supreme e kemi nga PZAP-ja edhe sipas këtij vendimi tash na jemi me një situatë krejtësisht të re, unë faktikisht vendimi jonë për de certifikimin e 86 kandidatëve të cilët kanë qenë të dënuar sipas aktgjykimeve të plotfuqishme të gjykatave të

Republikës së Kosovës janë de certifiku, ky vendim tashmë është anuluar dhe në fakt është inegzistentë që neve na vë në një pozitë tjetër tani dhe ne tash jemi pranë asaj që të marrim vendim çka më tutje, e kemi një rekomandim të zyrës.

Miradije Mavriqi: Ajo u tha se, në bazë të vendimit që e ka dorëzua PZAP vendimin e gjykatës supreme, atëherë gjykata e ka bërë d.m.th., që kjo e ka interpretuar nenin 29, pika 1, germa Q të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme..., për këtë zyra rekomandon anulimin e vendimeve për de certifikim që është marr me datën 10 shtator dhe 20 shtator për de certifikimin e 87 kandidatëve sepse, kan qenë edhe dy vendime pastaj: vendime të bazuara në aktgjykimin e plotfuqishmërisë të dërguara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Gjithashtu, zyra rekomandon kthimin e listave të kandidatëve të certifikuar që për zgjedhjet e 22 tetorit në gjendjen e para vendimit të marr me datat e lartcekura d.m.th me 10 shtator dhe 20 shtator të këtij viti. Ju, para vetës e keni listën e këtyre emrave që kthehen prapë në gjendjen ashtu siç kanë qenë, që për certifikim me 30 gusht të këtij viti.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoresh, në qoftë se e kuptova së pari nga ne kërkohet që të anulohet vendimi i decertifikimit, pra i datës 10 shtator dhe i datës 20 shtator për decertifikimin e 87 kandidatëve.

Betim Gjoshi: Së pari diçka teknikisht para se me u shpreh për atë qëndrimin tim në lidhje me procesin në përgjegjësi, unë po kërkoj me u plotësuar rekomandimi, edhe rekomandimi me qenë në këtë mënyrë, rekomandim për anulimin e vendimeve për decertifikimin edhe certifikim me numër kaq e kaq d.m.th., i anulojmë të dyja se janë të ndërlidhura. Na, në qoftë se i marrim na për me anuluar njanin ky automatikisht duhet me anuluar edhe tjetrin se, krijohet një gjendje e re e njëjta me qenë edhe te paragrafi 1 d.m.th., me numër romak 1 ku e keni shënuar e njëjta përmbajtje po në fund të vendimit me lanë një pasus se nëse, ndonjëri nga personat nuk don me u rikthye në listë me mbete aj i certifikum se, nashta dikush ma nuk donë me u rikthye në listë.

Ne, tha z. Gjoshi, nuk mujna me i detyruar njerëzit për me u rikthye në listë dhe kjo duhet me përfunduar deri nesër në ora 16:00, ose 18:00 varsishtë nga orari i punës. Ndërsa, sa i përket vendimit ju nëse me lejoni me e mar fjalën qitash, unë së pari ju e dini që ka për një kohë që jam antar i Komisionit Qendror Zgjedhor dhe është jashtëzakonisht e mirë që neve edhe në vendimet e gjykatës është konstatu që KQZ-ja nuk ka shkel ligjin, po është konstatu një gjendje që ligji është në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës. Unë, nuk du me koment, nuk komentoj në vendimet te gjykatave që kam në parim po është fat i mirë që 10 vite Komision Qendror Zgjedhor nuk bjen në kundërshtim me ligjin, të cilin e zbaton edhe ka detyrën se është lekspecial për këtë qështje, për qështjen e zgjedhjeve edhe për këtë na jem, edhe kushtetuta neve na kërkon që me zbatu këtë ligj edhe autorizimet që i kemi në kushtetut edhe të dyjat edhe certifikimi i kandidateve është e drejtë e jona me kushtetut hyn në këtë fushë. Kjo dëshmon se, edhe një herë që ligji i zgjedhjeve duhet me u riformu ashtu siq edhe kam kërkun në vazhdimsi që një kohë të gjatë edhe me u përshtat me rregullativen tjetër, është qështje e vlersimit tjetër, mu me vjen keq që një standadë që ka tentu edhe një vullnet i mirë me u ngrit nga institucioni i jonë është ardh si

rezultat i tillë në bazë të vendimit që neve na është sjell prej gjykatës supreme edhe kjo i bie që edhe ata që kanë kry masakra në Kosovë edhe të gjithë personat që kanë kry edhe krime lufte edhe krime ndaj çfarë do lloji, kanë të drejtë me kandidu nëse gjykata nuk ka marrë ndonjë vendim me ja heqë këtë të drejtë edhe këtë është mirë me dit opinionin publik kjo është jashtzakonishtë e rëndësishme, pra d.m.th kjo është situata, janë të barabartë me kandidu të gjithë, ata që janë votues të Kosovës me kandiduar do me thanë se Komisioni Qendror Zgjedhor iu ka mohu e drejta që me përjashtu dikë që naj njonin prej kritereve pa marrë parasysh llojin e krimin që e kanë bërë, me përjashtu prej zgjedhjeve....

Edhe unë mendoj, tha z. Gjoshi se edhe ligji nuk ka qenë në rregull në mënyrën qysh ka qenë pa u klasifikuar. Unë, e shprehi qëndrimin tim d.m.th që ne duhet me zbatu gjithsesi vendimin e gjykatës është prej gjykatës supreme ma të lartë, nuk kemi kohe me humb me ankimi këtë në rast eventual në gjykatë kushtetuese se do ta rrezikonte procesin zgjedhor, ne asniher si Komision Qendror Zgjedhor iu kam thanë edhe në mbledhjen e kaluar nuk është mirë të bëhemi pale në proces, edhe është mirë që nuk janë bërë, na e kemi zbatu ligjin këtë e ka konstatu edhe vendimi i gjykatës qfare është qaj që është, na d.m.th duhet me vazhdu ma tutje se përndryshe rrezikojmë procesin d.m.th na jem vonë ka dy ditë që ka fillu fushata zgjedhore edhe duhet me vazhdu ma tutje. E di që prej institucioneve tjera, kanë prioritete tjera, na i kena veq zgjedhjet edhe organizues sa ma të mira zgjedhjet edhe për këtë d.m.th e inkurajoj institucionin me vazhdu me punu ma tutje, kemi shtyp broshurat, fletëvotimet, fillon procesi i votimit jashtë vendit. Është dashtë me fillu dje, po nuk kemi mujt me fillu për shkak të kësaj problematike se nuk e kemi dit se kush janë kandidatët, pra sygjeroj që sa ma shpejtë me vazhdu edhe me përfundu far odiseada me kandidatë, me ato vërejtje që i thashë me i plotsu vendimet.

Valdete Daka: Unë në parim, as që më lejohet me i komentu aktgjykimet, sepse jamë vetë gjygtare, dhe nuk kisha dashtë që askush me i komentu vendimet e mijë. Por, gjithsesi qëndron fakti se KQZ-ja ka vepru sipas ligjit edhe e ka zbatu ligjin në mbas të cilit dhe egziston edhe punon . Pra, KQZ-ja zbaton ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale dhe në bazë të këti ligji dhe ne bazë te nenit 29 –të KQZ-ja ka qenë e obliguar që të veproj ashtu si ka vepruar. Se, çka ka ndodh me tutje dhe se cilat janë vendimet e gjykatave dhe instancave tjera, është çështje tjetër me te cilën, unë nuk jam marrë dhe as që do të merrem. Ne, do zbatojmë vendimin e gjykatës supreme çfarëdo qoftë ai dhe, edhe një herë i kisha bërë thirrje institucioneve kompetente që pasi të përfundon ky cikël i zgjedhjeve të merremi me këto ligje. Ndërkaq, se a janë në kundërshtim me kushtetutën a jo, me siguri që do të merret edhe gjykata kushtetuese, faleminderit, në qoftë se ka dikush diçka tjetër urdhëroni.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Realisht kryetarja pasi që vjen prej gjykatës nuk e komenton dhe është e drejtë e saj normalisht në kuptimin juridik unë s' mundem dhe ta komentoj si antar i KQZ-ës sigurisht se do të bëjë komentet e mijë dhe hezitimet e mijë që i kamë pas që nga fillimi, është e vërtet që KQZ-ja ka dashtë ta vendos standardin për herë të parë sepse ai ligj është nga 2008-shi dhe, ai nen ka egzistuar që të vendos një standard që në lista të ketë njerëz të cilët, nuk janë te ndershëm me ligjin. Edhe ka qenë gjithçka parimore dhe askush nuk ka pas

asgjë personale në atë punë, po megjithatë ky vendim e ka dhe një histori të vetën që pas disa ditësh të komunikimit edhe me këshillin gjyqësor edhe me gjykatat u pa që ato lista nuk janë te plota. Normalisht, ka qenë hezitimi në këtë rast ka qenë i imi që të votoj një listë sepse kam menduar që nuk është e plotë, është e vërtet që në këtë rast këshilli gjyqësor ka sjell një shkresë të cilën kanë thënë që i kemi përfunduar të gjitha identifikimin e të gjithë kandidatëve që kanë qenë nëpër lista.

Aët ditë, tha z. Hamiti, kam pas hezitim kamë thënë ishalla dhe uroj që të jetë e plotë, ka dalë që nuk është e plotë sepse ma vonë na kanë ardh dhe dy aktgjykime që kanë qenë te formes të re mirëpo se kanë kry punën qysh duhet, as ai segment, po themi që një javë anëtrët e KQZ-së kanë qenë në tapet në kuptimin e presionit publik dhe politik që të vendosin për këtë standard, dhe me at javë presionit shumë të madh publik, po flasë për anëtarët e KQZ-ës, është arrit që bëhet dhe të vendoset dhe me atë shkresë që ka ardhur dhe që duet që nuk është e plotë te këshilli gjyqësor. Tash, te interpretimi mas kemi vendos këtë shkon edhe paneli zgjedhor faktikisht i ka aprovuar vendimin tonë, vjen te interpretimi i gjykatës supreme nuk mundë të hy, po them unë tash tha dhe kryetarja, gjyqëtari nuk i komenton po megjithatë unë prej laikut këtë pjesë e shoh që gjykata supreme nuk e interpreton kushtetutën në këtë rast ata kanë hy dhe kane interpretua në kushtetutë dhe kanë marr vendim i cili është obligues për ne le te merret edhe le të merren tash edhe presioni politik dhe publik, vendimet që është marr në këtë rast gjithçka është konstatua që KQZ-ja nuk e ka shkel ligjin dhe kamë besim të plotë që se kemi shkel ligjin kemi ardh në një situatë te cilën kemi ardh, jo mirë për institucione por është marr një vendim çfarë e ka marr supremja, ka interpretua kushtetutën tash del që edhe gjithkush edhe do të interpreton kushtetutën.

Binak Vishaj: KQZ ka vendos këtë standard ligjor tu e pas parasysh ligjin mbi zgjedhjet e përgjithshme dhe atë lokale, ligj bazik me të cilin na funksionojmë edhe për të cilin na obigon ta respektojmë. Përveç kërkesës ligjore, ka qenë kërkesë edhe në politikë e të gjitha subjekteve politike dhe shteteve të kuintit të cilët kanë kërkuar nga ne që na ta vendosim këtë standardë. Edhe ne, e kemi vendos t'u u bazu në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe në aktgjykimet e gjykatave të vendit, kshtu që ne e kemi kryer punën tanë, nuk po e komentojmë vendimin e gjykatës supreme po dojmë me e vlersu edhe angazhimin tanë që e kemi pas edhe presionin ndaj nesh që është ba edhe në fund të fundit dul që ky vendim paska qenë në kundërshtim me kushtetutën. Nuk po du me jep vetit drejtë me gjyku ose me vlersu kushtetutën veq e di se në këtë vend kushtetutshmërin e bënë gjykata kushtetuese dhe jo dikush tjetër, sido qoftë unë jom me, tash me respektu vendimin e gjykatës supreme.

Adnan Rrustemi: Faleminderit, po është e vërtet që kjo çështje ka pas si me thanë një vëmendje edhe të gjerë të publikut, dhe të krerëve të tjerë si, dhe diskutim kogja të gjere në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve natyrisht që na si antarë të KQZ-së mendoj që i kemi pas në radhë të parë të gjitha rastet në kuptim as që i kemi shqyrtu, as natyrën e veprës, e as natyrën e dënimit, as masën e dënimit për secilin nga kto raste dhe është e vërteta ajo edhe qëndrimi që e keni pas të rezervuara me të drejtë d.m.th nuk është që i kemi bazu as në interesa politike e as ma tepër

personale, por ka qenë diskutimi në raport me kufizimin e një të drejte themelore në këtë rast, kushtetshmërin e dispozitës së ligjit, artibralitetin të këtij neni e kështu me radhë. Ashtu siç kemi thanë në vazhdimësi në disa mbledhjeve maratonike për këtë çështje, nuk është që ndonjë nga këto 85 raste më parë dhe 2 më vonë, siç me thanë nuk e meriton mos me qenë në listë mbase edhe në aspektin ligjor e veçmas në atë aspektin etik e moral.

Në anën tjetër, tha z. Rrustemi, si institucion por edhe institucionet tjera duhet të jemi kështu të garantohemi që kufizimi i një të drejte themelore të njeriut në këtë rast civile dhe politike të jetë në përputhje me kushtetutën dhe sidomos me konventa ndërkombëtare, standarde ndërkombëtare në këtë aspekt. D.m.th sepse duhet një lloj ekuilibrimi do të thoja të masës së kufizimit edhe me masën e veprës. Unë, nuk kam çka shtoj përveç atyre që kam thënë në të kaluarën, unë mendoj që vendimi i gjykatës supreme pa dyshim që duhet të zbatohet nga KQZ-ja dhe në bazë të këtij aktgjykimi ne po e sanojmë eventualisht një dëme që mund të jetë shkaktuar, nuk ka as një dyshim d.m.th. edhe aktgjykimi i gjykatës kushtetuese e konstaton që neni 29 pika në këtë rast është në kundërshtim me kushtetutën kur bëhet fjalë për kufizimin për të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.

Pa marr qëndrim individual për ndonjë rast që nuk e kemi as të njohur natyrën ne në parim duhet të, se nuk po flas veq për KQZ-ën por, në përgjithësi për institucionet kur bëhet fjalë për një kufizim të drejtës themelore duhet të jemi shumë do të thosha të sofistikuar raport me këtë. Unë këtë qëndrim kam, natyrisht që duhet ta zbatojmë këtë aktgjykim pajtohem me ato plotësimet e vendimit veçmas me atë që klauzolën në pikën e fundit që nëse eventualisht ndonjëri nga këta kandidat të de certifikuar po kthehen në garë, për arsye nga më të ndryshmet refuzon që të rikthehet sepse ne kemi bërë disa zëvendësime të na bëhet e njohur brenda këtij 24 orësh që nuk rikthehen dhe mbesin në fuqi kandidatët zëvendësues në këtë rast që të vazhdojmë me operacionet tjera me aktivitetet tjera dhe të fillon edhe shtypja, printimi dhe publikimi i listave të asamblistëve sepse ka filluar fushata e veçmas kur fillon edhe votimi jashtë vendit.

Eshref Vishi: Faleminderit kryetare. Edhe unë sikur kolegët nuk do të hyj në komentimin e aktgjykimit të gjykatës supreme, me qenëse se kandidatët e de certifikuar kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore për ankesë kundër vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe kundër vendimeve të BZAP-it dhe si rezultat kemi aktgjykimet të cilat janë obligative për zbatim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe si të tillë duhet të zbatohen. Unë mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të ec përpara me organizimin e zgjedhjeve dhe me planin operacional që ka para vetit.

Ilir Gashi: Faleminderit kryetare. Po jemi para një situatë krejt të re e cila natyrisht që edhe unë pajtohem edhe të gjithë po pajtohem se nuk do ti interpretojmë fare apo do ti respektojmë në plotni vendimet e gjykatës . Mirëpo ashtu siq kam thënë edhe herën e kaluar edhe tash tham që dilemat gjithmonë kanë qenë më shumë dilema morale sepse ligji mbi të cilin ne veprojmë është ligj që i ka barazuar veprat e kryera dhe këto kanë qenë arsyet pse ne i kemi shfaq dilemat tona morale, mirëpo edhe sot e mbrojmë qëndrimin që sa i përket pjesës ligjore. Ne si institucion,

kemi pasur vendim të drejtë, vendim i cili në fakt është bazuar në ligjin mbi të cilin ne veprimë sepse nuk kemi ligj tjetër, kushtetuta ashtu e ka përcaktuar se ky institucion vepron mbi ligjin e zgjedhjeve dhe natyrisht se edhe në këtë edhe ata jashtë që janë e dinë saktë që interpretimet në qoftë se dikush ka bërë shkelje kushtetuese interpretimet e saj i bënë vetëm një organ dhe shteti ka menduar për këtë edhe ajo është Gjykata Kushtetuese.

Pa dashur me hy më tutje, veç duhet ta bëjmë të qartë opinionit publik se ne nuk kemi pasur ndonjë vendim që i kemi thyer rregullat tona dhe kemi thy rregullin tonë por, kanë qenë në përputhshmëri të plotë me ligjet bazike me ligjin kryesorë, ligjin mbi zgjedhjet të cilët ne morëm vendime dhe veprimë. Edhe te kandidatet se dhe ata duhet ta kenë të qartë që ne vendimin tonë e kemi pasur të bazuar mbi nenin 29 të ligjit, mbi nenin të cilën edhe ata vet kanë nënshkruar një deklaratë që pajtohen se veprimet e tyre janë në përputhshmëri ma atë nen dhe mbi këtë bazë ne duhet të jemi të pastër sa i përket vendimeve tona karshi edhe tyre karshi edhe opinionit publik.

Bajram Ljatifi: KQZ , ne anëtarët e KQZ-së kemi ardhur në situatë që të mbrohen nga ligjet tona...Unë, i konsideroj se këto janë ligjet tona...Ne e dim çka është kushtetuta, ligji, aktet ligjore etj...Kemi ardhur në momentin kur, duhet t'i respektojmë organet e caktuara dhe ne, do ta respektojmë këtë...

Betim Gjoshi: Veç desha sa për sqarim të kolegëve që kushtetuta nuk e ka veç një nen d.m.th. është e vërtetë që një nen thotë që kanë të drejtë të kandidojnë të gjithë ata që nuk i ka ndaluar gjykata apo ka edhe një nen tjetër që thotë që të drejtat e njeriut kufizohen me ligj edhe me ligj e kanë kufizua këtë të drejtë, nuk e kemi nxjerr ligjin na, se i ka ra sikur na që e kemi nxjerr ligjin d.m.th ligji është në përputhje të plotë me kushtetutën...Por, këtë vend jan t'ue shkatërrua juristët që e lexojnë nga një paragraf të nenit po s'ka nen hiq dhe d.m.th., edhe kjo shpreh domosdoshmërinë, jo veç një reforme zgjedhore po edhe një reforme komplet sistemit të drejtësisë. Neve na ka ra hise si institucion, jemi institucioni që e kemi nxjerr vendin prej krizës edhe prej problemeve gjithmonë, edhe sot kemi ndërmarr në vazhden e saj që ne mos me kriju, me tregu seriozitetin tonë si institucion edhe pse brigandi jonë nuk vihej siç vihej atyre siç u deshtë me qenë ma të kujdesshëm, për rendin shtetëror edhe rendin kushtetues...Ky, mendoj ka qenë një atak i përgjithshëm kështu që besoj që do të vlerësohet edhe ma vonë edhe nga ekspertët tjerë kjo çështje që ka ndodh po ne do të vazhdojmë me punën se e kemi për detyrë me organizuar zgjedhjet, e kanë ardh me 22 tetor.

Valdete Daka: Me qenës nuk kemi tjetër çka me thanë në këtë drejtim, unë vetëm e qes në votim...

Ilir Gashi: Thjesht, ne po i rikthejmë në garë 87 kandidatë, po i largojmë 63, a 64 që i kemi certifikue, në ndërkohë nëse nga këta 87 ka ndonjë që nuk donë me i përfshi.

Valdete Daka: Atëherë kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së.

Valdete Daka: Faleminderit...Vazhdojmë me pikën tjetër: raporti i këshillave, por e kemi edhe rekomandimin për akreditimin të vëzhguesve...

2. Shqyrtimi dhe rekomandimi i akreditimit të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryesues, zyra duke u bazuar në nenin 54.1 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, nenit 19 të ligjit për zgjedhjet lokale dhe nenit 3 të rregullës zgjedhore numër 07/2013 për vëzhguesit e zgjedhjeve si, dhe duke u bazuar në planin operacional të KQZ-së deri me 21 shtator 2017 i ka procesuar aplikacionet e vëzhgueseve dhe atë, dy partitë politike, dy kandidatë të pavarur, një ambasadë, një organizatë ndërkombëtare, dy OJQ-ve ndërkombëtare, shtatë OJQ-ve vendore dhe dy media, me gjithsej 3.333 vëzhgues. Kushtet për të u akredituar vëzhguesit janë në përputhje me nenin 54 dhe 55 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, të nenit 19 të ligjit për zgjedhjet lokale, dhe nenit 3 të rregullës zgjedhore siç e cekim më lartë, gjithë vëzhguesit për veç atyre të emëruar nga ndonjë organizatë ndërqeveritare, qeveria e huaj ose OJQ-të të regjistruara në Kosovë duhet të jenë persona të regjistruar për votim në zgjedhje, këto janë kushtet ligjore.

Subjekti politik, duhet të parashtrojë formularë me plotësues të kërkesës për akreditim i cili e ka plotësuar e që do të thotë subjekti politik ka sjell deklaraten e nënshkruar nga secili vëzhgues, ka sjell versionin e shtypur dhe elektronik të listës vëzhguesve, në letër është e nënshkruar nga përfaqësuesja e autorizuar, vëzhguesi do të thotë është verifikues a është kandidatë përpos zgjedhor, anëtar i komisionit komunal zgjedhor apo anëtarë i këshillave të vendotimeve do të thotë janë verifikuar, këta vëzhgues nuk janë, vëzhguesi nuk duhet të jetë pjesëtar i policisë ushtarak apo i njësisë së inteligjencës të Kosovës do të thotë ose të një shteti tjetër gjithashtu është verifikuar, dhe vëzhguesi nuk mund të vëzhgojë procesin e zgjedhjeve nëse është nën hetime lidhur me zgjedhjet paraprake apo është i dënuar nga PZAP gjithashtu është verifikuar, kështu që zyra rekomandon që janë plotësuar të gjitha kushtet edhe rekomandon akreditimin e: 3.333 vëzhgueseve.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan akreditimin e këtyre vëzhguesve

(Këtu e tutje, mbledhjen e udhëheqë z. Bajram Ljatifi)

Anëtarët e KQZ-së, miratuan akreditimin e këtyre vëzhguesve

3.Raport i Këshillave

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime për zgjedhjet;

Adnan Rrustemi: Faleminderit kryesuese. Këshilli i operacioneve zgjedhore në mbledhjen e fundit ka shqyrtuar disa qështje që janë të lidhura me operacionet zgjedhore, nën pika e parë është rekomandimi për rritjen e numrit të votuesve në vendvotime për këto zgjedhje, respektivisht në baze të nenit 82.1 të ligjit për zgjedhje, që e përcakton numrin e votuesve deri në 750 për vendvotim, por dhe të drejtën dhe mundësin që KQZ-ja në raste të caktuara ta rrit këtë numër deri në 950. Ne, e kemi një rekomandim nga sekretariati që ta marrim një vendim të tillë, respektivisht ta miratojmë këtë rekomandim nga shpjegimet d.m.th bëhet e qartë që kjo rritje deri në 950 votues për qdo vendvotim i ngërthen 72 vendvotime, për fat të keq nuk e kemi një tabelë për me na ba të qartë se, për çfarë rritje bëhet fjalë se, jo në secilin rast rritet 950 po kufiri maksimal për të cilat mundet me u rrit numri i votuesve është 950. Qysh e rekomandon KQZ-në që ta miratoj këtë rekomandim, është një praktik e zakonshme për çdo zgjedhje që KQZ-ja vendos të votojë, faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KOZ-it

2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar për certifikimin e Listës së Votuesve për zgjedhjet lokale 2017

Adnan Rrustemi: Këshilli i operacioneve zgjedhore ka shqyrtuar edhe raportin e sekretariatit, respektivisht të shërbimit të votuesve për procesin e krijimit dhe të qertifikimit të listës përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e 22 tetorit të këtij viti, nga prezantimi dhe nga materiali që e kemi të bashkëangjitur d.m.th rezulton që lista përfundimtare e votuesve për zgjedhjet e 22 tetorit do të ketë **1.890.952** votues me dallim prej 12.603 votues më shumë në krahasim me zgjedhjet e 11 qershorit. Në zgjedhjet e 22 tetorit do të kemi 899 qendra të votimit me 10 qendra më shumë në krahasim me 11 qershorit, do të kemi 2505 vendvotime, ndërkohë ia vlen të theksohet që janë 14.176 votues të rinjë që kanë ba mbushur 18 vjet në mes të këtyre dy palë zgjedhjeve mbrenda këtij viti, sikurse janë 5252 votues që kanë ndërruar adresë, në anën tjetër vlen të theksohet që gjithë aktiviteti i krijimit të listës së votuesve është zhvilluar në përputhje me operacionet që e kemi përcaktuar dhe aktivitetet përkatëse, gjatë periudhës të shërbimit të votuesve kemi pas 139.876 vizita do të thotë në makinën kërkuese në ueb faqen e KQZ-së për tu njoftuar me lokacionin e qendrës së votimit, kemi pas 8218 kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit, po ashtu janë larguar 150 emra nga lista votuesve në bazë të vendimit të prerë të gjykatave të cilëve është hequr zotësia e veprimit. Votimi jashtë lista e votuesëve jashtë vendit përmban 10.0476 votues janë regjistru për gjatë periudhës së regjistrimit të votuesëve jashtë vendit, të cilët e kanë mundësin me votu gjatë këti muaji do të thojë, në fund e kemi të bashkangjitur një tabelë për numrin e votuesëve për cdo komunë, numëri I qendrave për cdo komunë, dhe numrin e votimeve për cdo komunë.

Kshilli, rekomandon KQZ-në që ta certifikon në përputhje me përgjegjësit ligjore, listen e votuesëve dhe që sekretariatit t'i hapet rrugët për aktivitetet tjera sic janë shtypja dhe printimi dhe shpërndarja e listave për ndarjen e votuesëve për cdo vendëvotim, ju faleminderit.

Betim Gjoshi: Faleminderit kryesuses, unë shfrytëzoj rastin me falenderu shërbimin përkatës që krijon listën e votuese, ka bërë një punë të jashtëzakonshme për me bërë listë sa ma të mirë me i vendos personat që kanë votu me kusht aty ku duhet, me i'u ofru shërbim qytetarëve në mënyr elektronike ne zyrat e tyre për me e ndërru vendëvotimin edhe shumë shërbimet e tjera që ndërliidhen për me ba një listë sa ma të mirë mirëpo kjo nuk na bënë pa fajin tonë nuk na bënë neve të jemi të qetë që ne po e bëjmë listën me të mirë, lista votuese vazhdon me problem të vjetera, e para nuk kemi arrit me e bërë nja kampanjë të duhur të edukimit të votuesëve për shërbimet që ne i kemi ofruar. Për këtë, kemi numër të jashtëzakonshëm te vogel të njerëze që I kanë shfrytëzu këto të drejta, e dyta nuk I kanë të gjitha institucionet prioritet të njejtë listen e votuesëve ashtu si e kemi pas ne, vazhdon të kemi problem me adresat ne Kosovë dhe ky process ka vazhdu me u degradu sidomos në vendet urbane dhe në shtetet e medha si Prishtina, Ferizaji, Mitrovica, dhe ne kemi problem me i aloku votustë në vendin ku duhet. Për këtë, ju kërkoj qytetarëve të Kosovës që të shërbehen me ëbfaqen tonë dhe të shikojn se ku e kanë vendëvotimin dmth uebfaqen tonë mund ta shikojn 24h se ku e kanë vendëvotimin që ditën e zgjedhëve të mos humbin kohë duke kërkuar se ku duhet të votojnë për zgjedhje.

Në përgjegjësi, qytetarët janë saktë të vendosur se ku votojnë, por mirë është që ata të shikojnë se ku dueht të votojnë...

Adnan Rrustemi: Po unë e dhashë rekomandimin e këshillit të operacionit zgjedhore natyrisht që sekeratariati ka bërë një punë një proces të krijimit të listës së votuesëve, por e vërtet që ne duhet t'i adresojmë disa prej shqetësimeve kurë bëhet fjalë për saktësin dhe përmbajtjen e listës së votuesëve dmth janë shqetësime të bazuara. Përsonalishtë, do të doja që këto të jenë zgjedhëjet e fundit që ne operojmë me një regjistër të tillë të të dhënave, kkeimi problem te thekësuar me listën e votuesëve veqmas me adresat e pa sakta të tyre që e vështërësojn caktimin e saktë të votuesëvem nëpër qendra të votimit sikurse e vështërësojn procesin e informimit të votuesëve pastaj se ku duhet të votojnë...

Krejtë këto, tha z, Rrustemi, kanë dhe implikime tjera për rrjedhojë në process zgjedhorë në pjesëmarrje më të ultë në vota të shumta me kushtë e kështu me radhë natyrishtë që ka dhe aspekte të tjera sic janë emrat e personave të vdekur e kështu më radhë, e vërtet është që institucionet prej të cilave KQZ-ja shërbehet me të dhëna po zhvillojnë aktivitete të cilat nuk janë të sinkronizuara me nevojat e Komisionit Qendror të Zgjedhëve, d.m.th., si institucion duhet të bëjmë qmos do ti japim prioritet pas këtyre zgjedhëve në fakt të japim prioritetin e duhur që politikat tona kur bëhet fjalë për regjistrin civil të jenë të harmonizuara me ARC-ën me ministrin e punëve të brendshme dhe si me thënë projektet e tyre të jenë në linjë të njejtë me projektet tona. D.m.th. duhet ta kemi synim strategjik që secili votues të ketë mundësi të votoj vërtet në lokacionin në vendbanimin ku jeton dhe mos të kemi telashe të tilla kur alokojnë votuesit nga një

cep të qytetit në cepin tjetër sidomos në komunitat e mëdha e sidomos në zonat urbane. Megjithatë ne në këto zgjedhje, nuk është që mund të bëjmë më tepër por, është një shqetsm që duhet me adresu...

Bajram Ljatifi: Kush është për...A apstenon kush, a është kundër kush...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it

3. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve për anëtar të KKZ-ve

Adnan Rrustemi: Po, në këshillin e operacioneve zgjedhore kemi shqyrtuar 4 kërkesa për terheqjen respektivisht zëvendësimin e 4 anëtarëve të komisioneve komunale zgjedhore në 4 komuna. Rekomandimin e sekretariatit po e bartim edhe si rekomandim të këshillit të operacioneve në KQZ-ë. e vërteta është si mendim personal është që si aktivitet është jashtëzakonisht i vonuar d.m.th. jemi shumë afër procesit zgjedhorë dhe zëvendësimet e tilla nuk janë shumë të bazuara qështë e vërteta dhe nuk është që i kontribuojnë shumë procesit, megjithatë si këshill kemi ardhur në përfundimin që duhet të rekomandojmë KQZ-ën që duhet ti miratoj zëvendësimet pas tërheqjeve tash më për arsye të ndryshme të këtyre 4 anëtarëve. Unë, nuk po i lexoj i ke si kryesues aktvendimet të cilat KQZ-ja duhet ti marr për secilin rast. Faleminderit.

Betim Gjoshi: Kryesues kjo është më se e drejtë, ne nuk po arrijmë me bo trupa nivelit të dytë profesionale me krejt angazhimin tonë që me certifiku paraprakisht edhe me ofru një program trajnimi për ta qysh para dy vitetve para zgjedhjeve, jo vetëm që nuk po na sjellin të njejtat subjekte politike por, po e sfidojnë edhe institucionet po i ndrojnë pak para zgjedhjeve. Është mirë që këtë msim me nxjerr sekretariati edhe për zgjedhje tjera me fut edhe në rregullore por, edhe me ndryshu edhe me ju tregu subjekteve politike që duhet të emërojnë personat të cilët nuk duhet me hy ne garë edhe të cilët nëse për qfardo arsye japin dorëheqje nuk kanë të drejtë mi zëvendësu më edhe ju mbetet vendi bosh në KKZ-ë ata le të mendojnë kënd me dërgu, ata janë trupë zgjedhore është njejtë sikut sot njëri nga ne me hy në garë zgjedhore edhe me lënë vendin vakant e tani me lyp me zëvendësu. Tash më po emërojnë disa persona të cilët nuk kanë ligjërisht përvojë edhe nuk kemi mundësi as trajnim me ju ofru se kanë ka kaluar edhe koha e trajnimit. Unë do ta mbështes rekomandimin e këshillit se nuk kemi edhe rrugë tjetër por, mirë është me marr kësi mësim sekretariati.

Binak Vishi: Ne, e kemi pasur një projekt ku i kemi ftuar subjektet politike me i dergu nga tre emra në mënyrë që këta 3 persona të cilët i kanë dërgu subjektet politike mi aftësu m'i përgatit me ligjin aktual për zgjedhjet e përgjithshme edhe ato lokale me kompetenca që kanë me bo me komisionin komunal zgjedhor dhe partit politike kanë pasur fond të mjaftushëm të njerëzve të aftësuar që kanë mundur në komisionin komunal zgjedhor për mi përfaqësu ata. Kështu që prap se prap përzgjedhja është e tyre por, nuk është që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka bërë diçka në këtë fushë që me ngrit nivelin e përfaqësimit në mënyre profesionale por, prap se prap partit janë ato që vendosin që kush janë atë që do ti përfaqësojnë edhe këtu në Komisione komunale zgjedhore.

Bajram Ljatifi: E hedh në votim rekomandimin: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it

4 Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit operacional të sigurisë për zgjedhjet lokale 2017

Adnan Rrustemi: Këshilli, ka shqyrtuar edhe draft planin operacional të sigurisë për ditën e zgjedhjeve. Ju e keni dokumentin e bashkangjitur në material, është një dokument i zakonshëm për qdo proces zgjedhor që ngërthen në vete aktivitete e KQZ-ës dhe bashkëpunimin e KQZ-ës me institucione tjera shtetërore policin, prokurorin e kështu me radhë në drejtim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor përmbanë ecurin dhe përgjegjsinë e secilit institucion që nga procesi i shpërndarjes së materialeve do të thojë veçmas ecurisë së ditës së zgjedhjeve, garantimi i sigurisë së materialeve e kështu me rrashë. Nuk ka ndonjë ndryshim nga e kaluara veçse, janë harmonizuar me llojin e zgjedhjeve dhe me natyrën e tyre që e rekomandojmë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ta miratojë si të tillë dhe të ndjek zbatimin në përputhje me nevojat.

Bajram Ljatifi: A dëshiron dikush të diskutojë lidhur me këtë pikë...?

Eshref Vishi: Faleminderit kryesues. U tha pak më herët se nuk ka ndryshu nga e kaluara ky dokument, unë mendoj se ky plani i sigurisë, plani operacional i sigurisë ka qenë dasht të plotësohet dhe ndryshohet...Ka nevojë të plotësohet dhe ndryshohet si i tillë, vërejtjet kanë qenë që nga zgjedhjet e jashtëzakonshme të Drenasit mirëpo, si duket administrata nuk e ka par të udhës që ky plan të hyjë në këtë kuptim që të plotësohet. Megjithatë do të mbetet për më tutje administratës që ta ketë parasysh që ky plan duhet edhe njëherë të hyjë në plotësim ndryshim pas këtyre zgjedhjeve.

Adnan Rrustemi: Personalisht pajtona që këtë dokument ka nevojë për një shqyrtim më të thellë edhe për plotësime edhe të funksioneve edhe të aktiviteteve por, me gjithatë në këtë fazë nuk është që ka mbërrirë me ju nënshtruar këtij shqyrtimi. Unë, personalisht veç ftoj zyrtarët përgjegjës në koordinim me institucionet tjera të bëjnë qështë e mundur që të shpërndajnë njoftimet dhe linjat e komunikimit dhe të lajmërimin të qytetarëve për qdo institucion nëpërmjet qendrave e vendvotimeve sidomos nëpërmjet telefonit që janë pa pagesë se ku mund të thrrasin qytetarët me paraqit një shkelje ose një kërcënim ose një ndërhyrje. Duhet të jenë në funksion ekipet e kujdestarisë, të prokurorisë dhe të institucioneve tjera që të jetë edhe i zbatueshëm por, edhe të sigurohet që në ditën e zgjedhjeve nuk do të ketë vështirësi që qytetari të qaset ose të marrë përgjigje edhe të ketë reagim të shpejt në qfardo parandalim.

Betim Gjoshi: Ne, do të bëjmë të gjitha përpjekjet përfshirë edhe sigurinë që të ofrojmë një proces sa më të qetë edhe fer. Ne për këtë d.m.th. ka tri palë zgjedhje që kemi dëshmuar organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të mra, ky është edhe vlerësimi i të gjithëve edhe këtu një

pjesë të kontributit të madh e ka dhënë policia, e Kosovës, prokuroria dhe gjykatat për të cilat duhet mi falenderu edhe me vazhdu me bashkëpun përfshirë edhe zbatimin e këtij planit të sigurisë që është i domosdoshëm për mbarvajtjen. Ju ju kujtohet edhe kur kemi pasur problem me zgjedhjen ju kam thënë nuk është KQZ-ja e vetmja palë në zgjedhje janë partitë politike janë organet e sigurisë janë edhe palët tjera që janë të përfshira, mediat, organizatat e shoqërisë civile, vëzhguesit të cilat i dhojnë kontribut edhe ngjyrë të mirë kërrij procesi edhe kjo që po miratojmë sot edhe në vazhdimësi bashkëpunimi me këta akterë i bënë që zgjedhjet me qenë më të mira. Se kot e kemi ne në qoftëse vetëm mundohemi me mbajt zgjedhje të mira. Faleminderit

Bajram Ljatifi: Mbasi që i shterrëm diskutimet, e hedh në votim rekomandimin e KOZ-it...Kush është për, a ka apstenim, kundërshtim...?

Nuk ka asnjë kundërshtim...Miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për procedura të votimit dhe numërimit

Adnan Rrustemi: Faleminderit. Këshilli Operacioneve Zgjedhore ka shqyrtu draft edhe doracakun për zgjedhjet lokale të 22 tetorit. Në përgjithësi është plotësuar kushtimisht po them në llojin dhe natyrën e zgjedhjeve por, edhe janë marr në bazë të disa vërejtjeve, rekomandimeve nga procesi i 11 qershorit me qëllimin që procesi i sjelljes së komisionarëve, i numërimit veçmas të jetë sa më i sakt dhe të na shmang çfarëdo parregullsie veçmas nga rinumërimet e shumta. Si risi përveç disa ilustrimeve është edhe forma e përputhjes së të dhënave të rezultateve që është thjeshtur për këto zgjedhje por, me gjithat do ta theksojmë që shëmbujt që janë përfshirë në doracak për fletëvotimet e vlefshme dhe të pavlefshme duhet të rishikohen edhe një herë nga sekretariati, kështu që ne sot e rekomandojmë KQZ-ën që ta miratoj si të tillë doracakun por, pa shtesat që në këtë rast ilustronë çka është ilustrimi i vlefshëm e çka është i pavlefshëm se ka disa pasaktësi rreth tyre duhet të fiksohen në mënyrë më të saktë që të kemi mesazh të sqartë për komisionerët në këtë rast se çka është fletëvotimi dhe cili është fletëvotimi i pavlefshëm dhe cili i vlefshëm. Ju faleminderit...

Betim Gjoshi: Unë, mendoj që doracaku që kemi para vetës është jashtëzakonisht material më i mirë se të gjitha zgjedhjet tjera, edhe për këtë e falenderoj sekretariatit por, edhe ekspertët tjerë që kanë kontribuar me qenë i tillë. Ofron shembuj më shumë, është më i thjeshtë me i saktë por, nuk është i vetmi ky si material nuk mundet me kry punën në qoftëse trajnimi nuk është në përputhje me doracakun. Për pjesën e shtojësës sa i përket fletëvotimeve të vlefshme të pavlefshme ja vlen mi rishiku edhe një herë edhe unë pajtona që të shtyhet për mbledhjen tjetër , e përkrahu doracakun dhe mendoj që ka me kontribu procesi zgjedhor nëse gëshëtohen në trajnime. Faleminderit.

Eshref Vishi: Pajtohem me parafolësit se në disa aspekte është i avancuar si përmbajtje doracaku për pos pjesës që ka të bëjë me shembujt e shtrojsave nëse eventualisht këto nuk janë shumë të

qarta por, megjithatë shtojcat e kryjen punën e vetë në kuptimin e trajnimit të trajnerëve dhe trajnimit të KVV-ve ose duhet të jenë më të zmadhuara ju që gjithë ato shembuj e fletëvotimeve të pavlefshme të jenë të qarta dhe të kuptueshme për trajnim të KVV-ve ose thjeshtë nëse nuk janë pjesë e doracakut të jenë pjesë e trajnimit gjithsesi.

Binak Vishi: Doracaku, është udhërrëfyese ose udhëzuese se si do të duhet të sillen anëtarët e këshillave të vendvotimit në vendvotim, edhe dilema jonë u heq dhe u tha që kjo pjesa e shtojcave duhet të largohet se janë të vendosura disa terma disa shembuj të cilat ne nuk i kemi nuk jemi dakorduar që ato të jenë aty. Me këtë pjesën e heqjes së shtojcave edhe unë jam që doracaku qysh është të kaloj pa shtojca.

Enis Halimi: Krejt në fund, në emër të sekretariatit dëshiroj që të falënderoj IFES-in për ndihmën e pakursyer profesionale dhe tjetër teknike që ka dhënë për tu arritur deri të një cilësi e tillë e doracakut për të cilin u konstatua prej të gjithëve se tash është më i mirë se kurrë herë . Faleminderit.

Bajram Ljatifi: Mbasi që i shterrëm diskutimet, e hedh në votim rekomandimin e KOZ-it...Kush është për, a ka apstenim, kundërshtim...?

Nuk ka asnjë kundërshtim...Miratohet ky rekomandim i KOZ-it.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Fletëvotimeve dhe Broshurave për zgjedhjet lokale 2017

Adnan Rrustemi: Po këshilli i operacioneve zgjedhore ka shqyrtuar sot dizajnin dhe përmbajtjen po themi të fletëvotimeve që do të përdoren edhe për kryetare edhe anëtarë të kuvendeve, ju i keni nga një ekzemplar për secilin lloj të zgjedhjeve do të thoj nga një komunë përkatëse sa për ilustrim. Si të tilla d.m.th. KOZ-i i rekomandon KQZ-ës që ti miratoj, natyrisht që përmbajnë të dhënat të zakonshme dhe të përhershme sikurse edhe elementet e sigurisë tash më të përcaktuara. Si risi mund të themi që janë zmadhura kuadratet kur bëhet fjalë për numrat e anëtarëve të kuvendeve me qëllim që me pas më të lehtë votuesit mu orientu dhe hapsira në mes të subjekteve politike. Unë nuk kam ndonjë gjë, e rekomandojmë d.m.th. KQZ-ën që ti miratoj si të tilla dhe të ftoj sekretariatit pas miratimit ti publikoj në ueb faqe sa më parë dhe të ju dërgoj votuesve jashtë vendit se që dje ka filluar procesi i votimit dhe në mungesë të fletëvotimeve kanë të pamundur.

Betim Gjoshi: Fletëvotimet janë pothuajse të zakonshme përveç kodit që ju ka shtu fletëvotimit te pjesa dengut si element i vërtetimit të numrit serik të tij. Është i njëjtë d.m.th. është e vërtetë i kemi krijuar një hapsirë më të mirë e subjekteve politike edhe kandidatëve për asamble, me qëllim e pëshatet fletëvotimet për zgjedhjet përkatëse janë espektuar të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë edhe gjuhët në përdorim varësisht prej komunës. Qka kisha kërku besoj që e ka bërë kryeshefi, një grup methemelu me kontrollu edhe broshura edhe fletëvotime me gabim eventual,

se mundet me na shkaku ndonjë gabim, kështu që është mirë në komision menjëherë pasi këtij takimi me vlerësu saktësinë edhe gabimet eventuale në fletëvotime se ne nuk mundemi me marr përgjegjshmëri që 70 e sa fletëvotime nuk kanë ndonjë gabim si për shembull një mbiemër me ja shkaku dikujt gabim një shkronjë të mbiemrit i shkaku problem gjatë garës zgjedhore. Na ka ndodhur të paktën në dy parë zgjedhjet lokale na ka ndodh, po ashtu edhe në broshura. D.m.th. është me rëndësi ju me themel një komision edhe për këtë duhet me autorizuar kryeshefin që nga kjo mbledhje një komision për të dhënat e sakta në fletëvotime apo si do që e emëroni. Faleminderit.

Adnan Rrustemi: Është e vërtetë, ne kemi pasur raste kur kemi bërë rishtypje të fletëvotimeve për arsye nga më të ndryshme por, kjo duhet të ndodhë ka mundësi që nuk është përfshirë kandidat e tjerë e tjerë sidomos në listat e asamblistëve, se ka pasur shumë zëvendësime, tërheqje nuk është që janë shoqëruar shumë, ka mundësi që janë duplikate edhe emrat kërkoj nga sekretariati që ti publikoj sa më parë listat e asamblistëve për çdo kuvend komunal për çdo komunë si dokument i vetëm në ueb faqe edhe vetë i kontrollojnë a janë inkorporuar zëvendësimet a jo se nuk i kemi të qarta, ende është e vjetra sidomos jo e para por, dikund ka mesazh nuk është e azhuruar kjo lista e kandidatëve në ueb faqe, ka ende gabime numra të njëjtë e tjerë. Ne duhet ta dimë që deri këtu kemi mujt me thënë po e presim po e presim por, nga sot e tutje duhet ti publikojmë listat.

Betim Gjoshi: Kryeshef po e shoh që po ngutesh me marr fjalën por ne po mundohemi me shtyp fletëvotime edhe broshura të sakta se në ditën e zgjedhjeve mundemi mi përmirësu. Kemi pas përvoja të tilla po flasim prej përvojës, ka mundur mos me tra me marr pjesë në organizmi të zgjedhjeve lokale më duket i ke të parat, kështu që na ka ra me pas kësaj gabime edhe është mirë me themel një komision. Përveq kësaj për me heq përgjegjshmëri është mirë pas përfundimit sot jo veq mi publiku në ueb faqe por, me ja u dërgu edhe partive. Dërgojuni partive mos kanë ndonjë vërejtje a sugjerim edhe e ndani përgjegjshmëri e gabimit eventuale se ndodhin gabimet eventuale për faj tonin e pa faj tonin. Se është e vërtetë se aq shumë kemi bërë ndryshime kështu që nuk e kemi të lehtë ne si anëtarë të Komisionit Qendror Zgjedhor nuk mund ta marrim këtë përgjegjësi nëse ti ke asigurancion, edhe qka kisha dasht me thon komisioni është mirë me qenë një përfaqësues i zyrës për regjistrim të partive politike. Kisha mëndu me udhëheq ndoshta drejtori i operacioneve zgjedhore, edhe veq një person tjetër nëse don me ta lehtësu tre vet me u marr me ndoshta i dizajni me shiku cilësinë e këtyre edhe me përfundu këtë punë. Ju faleminderit.

Enis Halimi: Ndoshta, drejtoresha ka me shtu por, është qështja me sqaru afatin e këtyre plotësimeve që u dha deri nesër këtë nuk e kam të qartë, edhe te ky komisioni meqenëse është zyra e familjarizuar me këto tema, unë mendoj që edhe staf ka mjaftueshëm, unë mendoj për veti ndoshta jam edhe gabim, që punën më mirë do ta kryejnë ata aty për shkak se veq me formu komisione komisione unë mendoj që jo zhagitet ndoshta veq zhagitja por, është edhe qështja e cilësisë për shkak të familjarizimit me materialin. Unë mendoj se, ato prej zyrës me na ardh se stafin e ka mjaftueshëm, resurset tjera i ka në dispozicion me qenë se materia është e njëjtë e kanë

përpunuar disa herë e kështu me rradhë. Përndryshe në aspektin formal e teknik komisioni për pesë minuta formohet nuk është prezent i kemi këtu krejt.

Betim Gjoshi: Nuk është nevoj me bo debat si i themelon ti themelon, por, nuk është veq zyra i prek edhe operacionet tjera është listën votuese për këtë e mendova, dizajnin në këtë rast, nuk e kan për detyrë me kqyr a janë veq kandidatët e njejtë në broshur, mbiemrin ju e dini që nuk ka veq një gjuhë në Kosovë e ke pas edhe një vërejtje gjatë certifikimit.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it

7. Shqyrtimi dhe miratimi i sasisë së broshurave dhe Fletëvotimeve për zgjedhjet lokale 2017

Adanan Rrustemi: Shkurtimisht kryesues, ju e keni të bashkangjitur një tabel e ka të përcaktuar sasinë e fletëvotimeve për çdo komunë dhe sasinë e broshurave të listave të kandidatëve për çdo komunë, natyrisht që kjo bëhet në përputhje me orientimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për uljen e sasisë së fletëvotimeve të listave të kandidatëve sidomos të fletëvotimeve, në përputhje me praktikën e rrumbullakimit të dengjeve në qdo vendvotim. I keni d.m.th. të dhënat, kisha dasht qështë e vërtëta kjo tabel me u plotësu me një kolon me numrin e votuesve për atë komunë dhe numri i fletëvotimeve për qdo komunë e rekomandojmë si të tillë d.m.th. në përgjithsi në instancë të fundit bjen numri fletëvotimeve për 84152 ose minus 4.66% më pak se numri i votuesve.

Betim Gjoshi: Nëse më lejon, unë e kam përkrah si të tillë me u miratu është mirë që të paktën të kemi mbërri me zvogëlu ashtu 4-5% këto 2-3 palë zgjedhje se përpara mbarojshim 10% më shumë. Por, mendim i jemi ka qenë sot në këshill mi maru 70% krahasuar me numrin e votuesve, duke i parë trendët që prej 2004-2005 duke mos e kaluar 50% asnjë herë numëri i votuesve që kanë marr pjesë në zgjedhje, sot kam rekomandu që me shku me 70% të fletëvotimeve por, e pamë që pak njëfar hezitimi por, për zgjedhjet tjera është mirë me mëndu se ligji nuk na ndalon, na thotë jo më shumë por, më pa nuk është që na ndalon. Është mirë me mëndu me proshu fletëvotime më shumë se spo dalin votues me votu. Ne për qdo rast i kemi rezervat që mujna me mbuluar ku dalin më shumë. Kjo, ke ajo çka deshta me pas përkujtim sekretariati për herat tjera...

Bajram Ljatifi: E hedh në votim rekomandimin e KOZ-it...Kush është për, a ka apstenim, a ka kundërshtim...?

Nuk ka asnjë kundërshtim...Miratohet ky rekomandim i KOZ-it. Ju falemnderit...Me kaq, kjo mbledhje është e mbyllur...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare

Bajram Ljatifi, anëtar
